



Gjendja në Fakultetin e Gjeoshkencave të Universitetit të Mitrovicës (UMIB)



Gjendja në Fakultetin e
Gjeoshkencave të Universitetit
të Mitrovicës (UMIB)



admovere

botues:

ADMOVEVERE

(drejtësi transicionale | edukim | paqëndërtim)

<http://admovere.org/>

ky raport u hartua nga:

Aulonë Memeti

Ardit Kika

hulumtues:

Aulonë Memeti

Ardit Kika

redaktor gjuhësor:

Gazmend Bërlajolli

fotografia në kopertinë:

Gazmend Bajri

dizajni i kopertinës dhe faqosja:

Envinion

shtypi:

Printing Press

shkurt 2020

Prishtinë

tirazhi: 300 kopje

hulumtimi dhe botimi u përkrahën nga:

KFOS (Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur)

ADMOVEVERE është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet (KITU), të mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të OJQ-së **ADMOVEVERE** dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), të KITU-së, e as të recensentëve.

ADMOVEVERE (drejtësi transicionale | edukim | paqëndërtim) angazhohet për ndërtimin e një shoqërie demokratike, promovimin e tolerancës e të bashkëjetesës dhe luftimin e paragjytimeve; dialogun mes komuniteteve të ndara për t'i tejkaluar mosmarrëveshjet, si dhe promovimin e praktikave të mira për drejtësi dhe pajtim. Fushat kryesore të organizatës janë të drejtat e njeriut, me theks të veçantë te drejtësia transicionale, edukimi dhe ndërtimi i paqes.

Për më shumë: <http://admovere.org/>

Përmbajtja

- 06** SHKURTESAT
- 07** FALËNDERIMET
- 09** HYRJA
- 11** HISTORIKU
- 13** AKREDITIMET
- 21** GJENDJA AKTUALE E STAFIT AKADEMIK
- 23** ANGAZHIMET, PENSIONIMET DHE KONKURSET PËR STAFIN AKADEMIK
- 27** INTERESIMI, VËSHTIRËSITË DHE SUKSESET NË STUDIME
- 33** GJENDJA SIPAS PROFESORËVE
- 39** PËRFUNDIMET
- 43** REFERENCAT

Shkurtesat

AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
BA	Bachelor
EE	Ekipi i Ekspertëve
FIMK	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike
FTU	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
KA	Komisioni i Ankesave
KEDS	Kosovo Electricity Distribution and Supply
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOS	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
KITU	Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
KShC	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
MA	Master
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MF	Ministria e Financave
N/A	E paaplikueshme
PhD	Philosophy Doctorate
SMIAL	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë
SMU	Sistemi i Menaxhimit Universitar
UA	Udhëzim Administrativ
UMIB	Universiteti i Mitrovicës «Isa Boletini»
UP	Universiteti i Prishtinës

Falënderime

Falënderojmë të gjithë ata që ndihmuan këtë publikim, në radhë të parë Rektoratin e UMIB-it, me në krye prof. dr. Alush Musaj, që na ndihmoi në forma të ndryshme për realizimin e këtij raporti, e me theks të veçantë Drejtorin e Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun në UMIB, z. Ahmet Jashari, i cili na i siguroi një mori materialesh. Duam po ashtu t'i falënderojmë dekanin e Fakultetit të Gjeoshkencave, prof. dr. Naser Peci, prodekanin dr. sc. Naser Zabeli, stafin akademik nga Fakulteti i Gjeoshkencave që bashkëpunuan duke na dhënë intervista: Zenun Elezaj, Gani Maliqi, Zafire Bajraktari, Sylejman Hyseni, Sabri Avdullahu, Behxhet Shala, Afrim Koliqi, si dhe sekretaren e fakultetit, Ermira Sopa.

Në fillim të këtij projekti dyshonim se me problemin e mosakreditimit të programeve mund të përballëshin edhe drejtime të caktuara në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK) dhe të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore (FTU), mirëpo pas hulumtimit dhe intervistave me drejtues e profesorë në të dy këto fakultete, kuptuam se ky dyshim ishte i pabazë. Sido që të jetë, falënderojmë dekanin e FIMK-ut, prof. dr. Hakif Zeqiri për gatishmërinë për të na ndihmuar. Për ndihmën e pakursyer falënderojmë edhe profesorët e FIMK-ut: Avdi Salihu, Faton Merovci, Fisnik Osmani, Edita Bekteshi, Ahmet Latifi, Myzafer Shala, Lumnije Thaçi, Arbëri Krasniqi dhe sekretarin Artan Osmani për ndihmën me


kontakte. Gjithashtu, falënderojmë dekanin e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, prof. asoc. dr. Milaim Sadiku dhe prodekanin prof. asoc. Mensur Kelmendi, të cilët na dhanë intervista, duke mos ngurruar fare që të na përgjigjeshin. Falënderojmë edhe profesorët e Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore, Blerim Baruti, Florent Dobroshti dhe Besire Cena, të cilët pa përtesë na pranuan për intervista.

Një falënderim të veçantë meritojnë drejtuesit e ndërmarrjeve që na ndihmuan me të dhëna të ndryshme: Skënder Bucolli, drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun në KEK, Valded Gjinovci, drejtor ekzekutiv në AUV, Ramiz Krasniqi, drejtor i KPMM, Gent Bakija, Menaxher i Burimeve Njerëzore në Korporatën 'Rugove', Shqiprim Jashari, Menaxher i Burimeve Njerëzore në 'Fluidi', si dhe Gani Durmishaj, Drejtor i Qumështores Aldi. Njëherësh, falënderojmë znj. Vjollca Krasniqi, zv. Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë së AKA-së, për ndihmën e pakursyer gjatë këtij projekti.

Në fund, falënderojmë Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) për mbështetjen financiare për hulumtimin dhe botimin e këtij raporti, Gazmend Bërlajollin për redaktimin gjuhësor, Gazmend Bajrin për fotografimin e kopertinës dhe Faton Selanin nga Envinion për dizajnin e faqosjen, si dhe Printing Press për shtypin e këtij raporti.



Retsch



HYRJA

Mosakreditimi institucional i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB) në procesin e fundit të akreditimit në korrik 2019¹, nxiti reagime të shumta.² ³ Meqë është fjala për profile studimi, siç janë programet e Fakultetit të Gjeoshkencave që nuk ofrohen tjetërkund në Kosovë, ç’pasoja do të sillte mbyllja e tyre për ekonominë dhe industrinë e vendit? Ky publikim përqendrohet në rrezikun e mosakreditimit institucional të UMIB-it për herë të dytë, me ç’rast programe deficitare studimi do të ishin në rrezik të shuarjes, si dhe implikimet që kjo do të kishte për ekonominë e vendit.

Shqyrtohen edhe numrat e regjistrimeve të studentëve në të gjitha nivelet për drejtimitet përkatëse në Gjeoshkenca për periudhën 2014/15–2018/19, për të mësuar sa joshëse janë ato për studime. Raporti synon të nxisë debat publik mbi këtë çështje të rëndësishme, në mënyrë që të shtohet presioni te organet vendimmarrëse për të mos i mbyllur këto drejtimeve.

Për të kuptuar situatën pas heqjes së akreditimit institucional për UMIB-in dhe për të mësuar nëse ekziston rreziku i mbylljes së ndonjërit nga programet studimore të Gjeoshkencave, analizuam:

- raportet e akreditimit të ekspertëve ndërkombëtarë për UMIB-in;
- vendimet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC);
- ankesën e UMIB-it për mosakreditim drejtuar KShC-së;
- dokumentet e tjera relevante si Statuti, Kodi i Etikës dhe rregulloret e tjera;
- CV-të e stafit aktual të rregullt akademik dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm;
- listat e personelit akademik me marrëdhënie të rregullt pune dhe listat e bashkëpunëtorëve të jashtëm, të angazhuar për ligjërata dhe ushtrime;
- listën e profesorëve të pensionuar në pesë vjetët e fundit;

- konkurset për pozita të rregullta mësimdhënëse;
- pasqyrat e numrit të studentëve, të regjistruar nëpër vitet akademike;
- rezultatet e konkurseve për bursa nga UMIB-i;
- numrin e studentëve të UMIB-it që kanë kryer praktikë në këto ndërmarrje në 5 vjetët e fundit;
- numrin e studentëve të UMIB-it që kanë marrë bursa nga këto ndërmarrje;

Përveç këtyre, për t'i hetuar pasojat nga mbyllja e programeve të UMIB-it me të cilat mund të ballafaqohen disa nga ndërmarrjet më të mëdha minerare, energjetike e industriale (TREPÇA, KEK, FERRONIKELI), institucionet shtetërore të fushës (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM), si dhe për ta kuptuar gjendjen aktuale të këtyre ndërmarrjeve lidhur me kuadrot, hulumtuam edhe për:

Për këtë raport zhvilluam edhe intervista me Rektoratit e UMIB-it, Dekanin dhe Prodekanin e Gjeoshkencave, profesorë dhe ish-profesorë të këtij fakulteti, me inxhinierë e ekspertë të drejtimeve përkatëse nga vetë industria, si dhe me përfaqësuesit e KShC-së dhe të AKA-s.

- sfidat kryesore me plotësime kuadrove profesionale të cilat i ndeshin ndërmarrjet e mësipërme;
- profilet profesionale më të kërkuara nga këto ndërmarrje;
- programet studimore në Gjeoshkenca nga të cilat këto ndërmarrje kërkojnë kuadro të diplomuara;
- numrin e inxhinierëve të punësuar në këto ndërmarrje dhe moshën mesatare të tyre;
- numrin e inxhinierëve të pensionuar në 5 vjetët e fundit;
- numrin e inxhinierëve që do të pensionohen në 5 vjetët e ardhshëm;
- numrin e të diplomuarve nga UMIB-i të punësuar nga këto ndërmarrje në 5 vjetët e fundit;

HISTORIKU

Themelet e studimeve të xehetarisë, teknologjisë dhe metalurgjisë u vunë me hapjen e Shkollës së Lartë Teknike në Mitrovicë në vitin 1961. Në vitin e parë shkollor (1961/62) u regjistruan vetëm studentë të xehetarisë. Pak vjet më vonë u themeluan edhe dega e teknologjisë (1963) dhe e metalurgjisë (1969). Më 1970, në kuadër të Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës (UP) u hapën dega e xehetarisë, e teknologjisë dhe e metalurgjisë në Mitrovicë. Studimet në këto drejtime vazhduan në Prishtinë deri në themelimin e Fakultetit të Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë nga Kuvendi i Kosovës më 22 korrik 1974. Më 1978, në kuadër të Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë u themelua Instituti për Kërkime në Teknologji, Xehetari dhe Metalurgji. Në vitin shkollor 1980/81 u hap edhe dega e gjeologjisë, duke ia shtuar fakultetit programin e katërt të studimit.

Pas heqjes së autonomisë së Krahinës Autonome të Kosovës më 1989 dhe fillimit të përjashtimit të shqiptarëve nga institucionet arsimore, objekteti i Fakultetit të Xehetarisë e Metalurgjisë si dhe Shkolla e Lartë Teknike u ndaluan për personelin dhe studentët shqiptarë. Ndër “masat e përkohshme” të kohës ishte vendimi i Kuvendit Popullor të Serbisë i datës 19 mars 1991, sipas të cilit shkollat e larta të Kosovës u shkëputën nga UP-ja dhe u bënë pjesë e Bashkësisë së Shkollave të Larta të Serbisë. “Masat e dhunshme”⁴ prekën edhe FXM-në, e cila pasi u përjashtua nga objektet mësimore

në veriun e Mitrovicës⁵, vazhdoi punën në shkollën fillore “Abdullah Shabani” të qytetit dhe “Skënderbeu” të fshatit Vaganicë. Fill pas luftës, në vitin e parë akademik 2001/2002 studimet në Fakultetin e Xehetarisë dhe Metalurgjisë u organizuan sipas planprogrameve të miratuara nga Senati i UP-së, mbështetur në Deklaratën e Bolonjës, në nivelet Bachelor dhe Master. Më 2007, Këshilli Drejtues, i bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës (UP) themeloi Institutin për Kërkime në Teknologji, Xehetari dhe Metalurgji. Nga viti akademik 2008/2009 përveç studimeve Bachelor organizohen edhe studimet Master. Në vitin 2011, me vendimin e Këshillit Drejtues të UP-së, emërtimi i Fakultetit ndërron nga Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë. Më 6 mars 2013 Qeveria e Kosovës mori vendim që të themelohet Universiteti i Mitrovicës, kursee Kuvendi i Kosovës ia ratifikoi statutin më 31 maj 2013. Aktualisht, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB) ka gjithsej 22 programe studimi në 6 fakultete: Fakulteti i Gjeoshkencave, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Juridik, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike e Kompjuterike dhe Fakulteti i Edukimit.⁶ Fakulteti i Gjeoshkencave ka 3 programe në nivelin BA të studimeve – xehetari, gjeologji si dhe materiale dhe metalurgji – kurse në nivelin MA të studimeve ka xehetari, metalurgji, materiale, vendburimet e lëndëve të para minerale dhe hidrogeologji me gjeologji inxhinierike.



AKREDITIMET

Më 15 korrik 2019 AKA-ja vendosi t'ia hiqte akreditimin institucional UMIB-it për një mori arsyesh. Arsyetimi fillestar i vendimit ishte se nuk i plotësonte ose i plotësonte pjesërisht kapitujt e Manualit për Akreditim. Njëri nga 11 kapitujt e Manualit për Akreditim (Standardi për Planifikim Strategjik, Qeverisja dhe Administrimi) nuk ishte plotësuar fare. Ndërkaq, sipas AKA-së, 10 kapitujt e tjerë UMIB i plotësonte pjesërisht. Heqja e akreditimit paraqet rrezikun më të madh për UMIB-in meqë Ligji për Arsimin e Lartë përcakton se në rast dështimi për akreditim institucional herën e dytë, institucionit i hiqet licenca.

Deklarata e Misionit

Në vendimin e AKA-së figurojnë 4 vërejtje për Deklaratën e Misionit të UMIB-it. Së pari, aty shkruhet se “nuk është etike” që kapitulli i Deklaratës së Misionit është deri në 53% kopje e një deklaratë të misionit të një universiteti tjetër publik të Kosovës. Së dyti, thuhet se misioni, si dokument, nuk i ka elementet që “ofrojnë menaxhim të duhur në vendimarrjen e institucionit” dhe nuk ka udhëzime të qarta për planifikim, vendimarrje dhe aktivitete. Së treti, përmendet mungesa e dijenisë së stafit për misionin e universitetit. Së katërti, sipas vendimit, pavarësisht se ekziston organi që e

rishikon deklaratën, nuk ka pasur dëshmi se janë bërë konsultime me aktorë të jashtëm.⁷

Plani strategjik

Strategjia e UMIB-it, sipas vendimit, nuk ka kaluar nëpër konsultimet e duhura, përputhet me buxhet dhe afatet e zbatimit. Konsultimet e jashtme, sipas vlerësimit, nuk i kanë përfshirë grupet si studentët dhe përfaqësuesit e tregut të punës (punëdhënësit). Sa për raportin strategji-buxhet, ekspertët kanë vlerësuar se “planifikimi strategjik nuk është i përfshirë në proceset e lidhura me buxhetin”, që vë në pah shpërputhjen midis prioriteteve të Planit Strategjik dhe atyre financiare. Vërejtja e fundit në këtë pjesë është ajo mbi mungesën e planifikimit për realizimin e objektivave të caktuar, në bazë të të cilës u vlerësua se “nuk ka masa të matshme, targete apo indikatorë të performancës” për kohë të caktuar, që e ka bërë të pamundshëm vlerësimin e përparimit të universitetit në realizimin e planit të tij.

Detyrat e menaxhmentit dhe stafi administrativ

Ekspertët e AKA-së i kanë identifikuar dy probleme në lidhje me stafin. I pari, stafi që paraqitet në Raportin e Vetëvlerësimit (në pjesën e organogramit) nuk përputhet

me stafin e paraqitur te organogrami në Statut. Kjo, sipas tyre, ua ka pamundësuar të vlerësojnë a janë përgjegjësitë e strukturave qeverisëse të përcaktuara qartë dhe a realizohen në praktikë. Së dyti, gjatë vizitës në UMIB, ekspertët kanë vërejtur se një pjesë e stafit administrativ nuk ka qenë në vendin e punës. Në këtë pikë, ekspertët janë shprehur të shqetësuar në lidhje me mënyrën se si “menaxhmenti i përgjigjet nevojave institucionale” për funksionim dhe organizim efektiv të administratës.

Qëndrueshmëria financiare

AKA ka vlerësuar se UMIB-i nuk ka qëndrueshmëri financiare. Fakti që universiteti ka buxhet njëvjetor dhe trevjetor nuk i ka bindur ekspertët në lidhje me qëndrueshmërinë. Sipas tyre, “universiteti nuk ka ofruar informacione ose analiza të mjaftueshme për projektet e ardhshme” për fusha si mbështetja e studentëve (bursat), zhvillimi i stafit dhe hulumtimi shkencor.

Kodi i Etikës

Kodi i Etikës nuk ishte i publikuar në faqe, madje në raport thuhet se UMIB-i nuk i është përgjigjur fare kërkesës së ekspertëve për të dhënat e sjelljes së keqe akademike, plagjiaturën dhe kopjimin. Shumica e stafit akademik nuk ishte në dijeni që UMIB kishte kod të etikës. Këto gjetje, ndër të tjera, i shtynë ekspertët të dalin në përfundimin se mekanizmat e zbatimit të standardeve etike “nuk janë të qarta dhe transparente mjaftueshëm” dhe se kodi duhet të jetë “më i parashikueshëm” kur bëhet fjalë për vendimet që mund të merren në bazë të tij.

Vlerësimi i cilësisë

Sa i përket vlerësimin të cilësisë, sipas ekspertëve, UMIB-i nuk e ka krijuar një sistem “të përcaktuar të planifikimit, zbatimit, vlerësimin dhe rishikimit”. Po ashtu, pjesëtarët e stafit, të intervistuar nga ekspertët, kanë pasur vështirësi të tregonin shembuj për një sistem të integruar të sigurimit të cilësisë. Ndonëse ekspertët nuk kanë bërë komente në Rregulloren për Cilësi, ata kanë vlerësuar se ajo nuk është zbatuar edhe një vit pas aprovimit.⁸

Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Vërejtje të ekspertëve kishte edhe për mosekzistimin e një instrumenti formal të cilësisë përveç vlerësimin të cilin e bëjnë studentët për lëndët. Sipas tyre, nuk ka qenë e mundshme të identifikohen “metodat inovative të mësimdhënies që i pëfshijnë studentët si pjesëmarrës aktivë”. Metodatat e përdorura, vlerësojnë ekspertët, janë të orientuara drejt mësimarrjes nga studentët.

Hulumtimi

UMIB-i nuk ka mundur t’i bindë ekspertët se ka plan hulumtimi, parime hulumtuese a motiv hulumtimi brenda universitetit. Plani i hulumtimit ishte i aprovuar ose në ndonjë draft përfundimtar. Veç tjerash, ekspertët nuk ishin bindur në lidhje me zbatimin e parimeve hulumtuese të prezantuara nga UMIB-i, meqë u kanë munguar objektivat dhe prioritetet e hulumtimeve. Në fund, ekspertët kanë përmendur kulturën e pazhvilluar të hulumtimit, buxhetin e vogël dhe motivin e ulët të stafit akademik për publikime në revista kredibile shkencore, për shkak se rolin e tyre e shohin vetëm si profesorë.

Punësimi i stafit dhe Plani për Zhvillimin e Stafit Akademik

Në vendimin për heqje të akreditimit shkruhet se ekspertët nuk kanë mundur ta vlerësojnë zbatimin e planit për zhvillimin e stafit, se nuk ka doracak për stafin ose aplikantët për punë në universitet dhe se stafit nuk i bëhet vlerësimi i cilësisë. Së pari, plani i zhvillimit të stafit ka rezultuar i pamundshëm për t'u vlerësuar prej ekspertëve, sepse nuk ka caqe të matshme as buxhet të ndarë për zbatimin e tij. Së dyti, ekspertët kanë vërejtur se nuk ka ndonjë doracak a fletushkë që do t'ia përshkruante secilit aplikant ose të punësuar detyrat dhe përgjegjësitë dhe t'i jepte informacione të tjera të vlefshme. Së treti, në raport thuhet se UMIB-i e ka pranuar se nuk ka zhvilluar ndonjëherë "procedurë të rishikimit të performancës së stafit" që do të kishte tregues konkretë dhe rezultate konkrete (si rigradimi ose ndryshimi i pagës).⁹

Menaxhimi i studentëve

Vlerësimi i ekspertëve për menaxhimin e studentëve ka pasur vërejtje rreth informacioneve të publikuara, pyetsorëve për studentët dhe më së shumti mbi mungesën e informacioneve dhe mospërdorimin tyre. Së pari, ekspertët kanë konstatuar se ka mungesa të të dhënave për pranimin e studentëve të rinj. Së dyti, kanë konstatuar se pyetsorët kanë pasur pyetje që u referohen shërbimeve të cilat UMIB-i nuk i ofron ose i ka shumë të përgjithshme. Së treti, ekspertët kanë vlerësuar se nuk ka të dhëna për profilin e popullsisë studentore, karrierën e të diplomuarve dhe arsyet e braktisjes së studimeve dhe se edhe të dhënat aktuale (suksesi, braktisja dhe kënaqshmëria e studentëve) nuk përdoren mjaftueshëm.

Në raport thuhet se të dhënat e tilla nuk po përdoren në mbështetje të vendimmarrjes dhe të sigurimit të cilësisë.

Infrastruktura dhe TI

Në seksionin mbi hapësirat dhe infrastrukturën, ekspertët kanë numëruar 7 objekte/hapësira që i mungojnë UMIB-it: biblioteka universitare (që njëherësh është mungesë e literaturës), laboratorët për shkencë shoqërore, hapësirat rekreative, bufeja, por edhe objektet sportive, mjekësore e të banimit për studentët. Vërejtja e përgjithshme e ekspertëve lidhur me TI-në ka qenë se "sistemi dhe softueri i përdorur në proceset arsimore nuk azhurohen sipas punës dhe nevojave të tregut".¹⁰

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

Kapitulli për bashkëpunimin me institucionet e tjera ka dhënë vlerësim në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe atë me ndërmarrjet. AKA-ja ka vlerësuar se UMIB-i nuk ka strategji për ndërkombëtarizim, ndërsa marrëveshjet që iu kanë prezantuar ekspertëve, kanë qenë sipas tyre, joaktive. Ndërkombëtarizimi i UMIB-it, sipas ekspertëve, duhet të bëhet në mënyrë institucionale dhe të mos lihet në iniciativën e anëtarëve individualë të stafit. Lidhur me ndërmarrjet dhe profesionistët e tjerë, ekspertët ka dalë në përfundim se nuk kanë gjetur dëshmi për ta vlerësuar përfshirjen e tyre në komisione për përpilimin e programeve studimore. Ekspertët kanë vlerësuar se nuk ka komunikim sistematik me ndërmarrjet për të mësuar se cilat janë kërkesat e tyre për të diplomuarit e universitetit.¹¹

Ankesa e UMIB-it ndaj KShC-së

Më 7 gusht 2019, rektori Alush Musaj bëri ankesë në Komisionin për Ankesa të AKA-së kundër vendimit të Këshillit Shtetëror për Cilësi (KShC) të datës 29 korrik 2019 për mosakreditimin e institucionit të UMIB-it. Sipas ankesës, vendimi i KShC-së është nxjerrë si rezultat i shkeljes së dispozitave mbi procedurën e marrjes së vendimit, i konstatimit të gabuar të gjendjes dhe i zbatimit të gabuar të ligjit dhe rregullave të zbatueshme. Pra, UMIB-i ka kërkuar anulimin e vendimit të KShC-së mbi këto tri baza, kurse fillimisht ka paraqitur prova dhe argumente për shkelje të dispozitave dhe për konstatimin e gabuar të gjendjes faktike.

Sa i përket shkeljes së dispozitave, UMIB-i argumenton se, bazuar në Udhëzimin Administrativ (UA) 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, këto duhet t'i dorëzohen AKA-së komentet lidhur me projekt-raportin e vlerësimit të ekspertëve të jashtëm më së largu brenda dy javësh pas pranimit të tij, kurse UMIB-it i është caktuar afat prej tri ditëve. Sipas ankesës, KShC-ja ka bërë shkelje të procedurave dhe afateve të parapara me UA, duke mos i ofruar afatin e paraparë.

Ndërkaq, lidhur me konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, UMIB ka paraqitur një sërë argumentesh e provash me qëllim që të dëshmojë se gjendja e përshkruar nga Ekipi i Ekspertëve (EE) në vlerësim dhe arsyetimi i vendimit të KShC-së nr. 1356/19D në shumë raste nuk përkojnë me gjendjen faktike. Për të dëshmuar se është konstatuar gabimisht gjendja faktike, UMIB

ka paraqitur prova lidhur me 12 kapituj, 11 nga të cilat shqyrtohen në detaje në vendimin për heqjen e akreditimit:

Misioni i Universitetit

Pohimin e vendimit për mosakreditim të UMIB-it se “nuk është etike” që kapitulli i Deklaratës së Misionit të jetë deri në 53% kopje e një deklarate misioni të një universiteti tjetër publik të Kosovës, UMIB nuk e mohon. Fakti që UMIB ka statut të njëjtë me UP-në nuk do të thotë se ia kopjon veprimtarinë akademike. Misioni i universitetit, i përshkruar në statutin e përkohshëm të UMIB-it, është hartuar dhe miratuar nga MASHT në vitin 2013. UMIB ka pohuar se që nga ndarja nga UP-ja në vitin 2015, përfaqësuesit e tij kanë kërkuar në vazhdimësi hartimin e statutit të ri, por nuk ka pasur gatishmëri dhe përkrahje nga MASHT.¹²

Plani strategjik

UMIB-i nuk ka pasur komente ndaj konstatimit të ekspertëve se Plani Strategjik është bërë pa indikatorë, konsultime me punëdhënësit, masa të matshme e caqe të sakta, a koordinim të procesit të hartimit të planit me proceset buxhetore. Megjithatë, ankesa e konteston konstatimin se nuk ka pasur konsultime me studentë, duke paraqitur si provë emaillet drejtuar njësive akademike për konsultim, MASHT-it, vendimin për themelimin e një komisioni për përpilimin e planit strategjik, si dhe nenet e pjesët nga Statuti që dëshmojnë se studentët janë pjesë e këshillave të fakulteteve.¹³

Qëndrueshmëria financiare

Në këtë pjesë të ankesës përmenden planet ose projektet specifike, pavarësisht se ekspertët kanë shkruar se nuk i kanë parë. Megjithatë, UMIB-i i ka paraqitur 6 argumente për ta dëshmuar qëndrueshmërinë financiare. Në to përfshihet: rritja e buxhetit nga 3.15 milionë në 4.78 milionë (mbi 50%), ndryshimet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, lënia në dispozicion të buxhetit shtesë për realizimin e planit strategjik, mundësia e përdorimit të kategorive “mallra e shpenzime” dhe “subvencione” për qëllime të ndryshme (mobilitet akademik, ndërkombëtarizim, bursa, vizita studimore), si dhe mundësia e investimeve në laboratore në bazë të dy kornizave të reja të shpenzimeve. Në fund, si mangësi e përgjithshme përmendet mosaprovimi i një ligji të ri për arsimin e lartë, përmes të cilit universiteti krijon të hyra vetanake.¹⁴

Kodi i Etikës

Sipas UMIB-it, Kodi i Etikës ka qenë i publikuar që nga dita e aprovimit në shkurt 2016 në kategorinë e rregulloreve të faqja e Universitetit. UMIB konteston edhe komentet e ekspertëve se kodi nuk është i parashikueshëm sa u përket masave disiplinore që mund të merren nga zbatimi i tij. UMIB-i ka argumentuar se neni 35 i bën të qarta masat. Pavarësisht se në ankesë nuk ka treguar për rastet e sjelljeve të këqija akademike të ndëshkuara, UMIB e ka përshkruar komisionin hartues të kodit si të përkushtuar.¹⁵

Sigurimi i cilësisë

Lidhur me cilësinë, UMIB nuk ka komentuar mbi konstatimin mbi mungesën

e sistemit që ka mekanizma për planifikim, zbatim, vlerësim e rishikim. Megjithatë, ka shtuar se pyetsorët dhënë studentëve përbajnë pyetje edhe për stafin menaxhues dhe atë administrativ. Sugjerimit të ekspertëve se të dhënat e studentëve nuk po përdoren mjaftueshëm për t'i shërbyer vendimarrjes, universiteti i është përgjigjur se databaza është e qasshme për të gjithë stafin.¹⁶

Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Në ankesën e UMIB-it shkruan se ekzistimi i Rregullores për Sigurimin e Cilësisë është fakti që e bën të paqëndrueshëm konstatimin e ekspertëve se universiteti nuk ka ndonjë instrument formal të sigurimit të cilësisë. Për argumentimin e metodave inovative mësimore, UMIB-i ka shkruar se studentët njoftohen se si shërbejnë pikat e syllabuseve në praktikë dhe se ka projekte ku stimulohet puna në ekip e në terren drejt zgjidhjes së problemeve konkrete. Dëshmitë për këtë kanë qenë Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë, provat e prezantimit të dy studentëve dhe kontrata e projektit “Innovative Teaching in Mathematics” me periudhë zbatimi 2018-2021.¹⁷

Plani i hulumtimit

Ankesa e UMIB nuk komenton mbi mungesën e kulturës hulumtuese, të motivit për hulumtim, të objektivave dhe të projekteve hulumtuese. Megjithatë universiteti e vlerëson të paqëndrueshëm pohimin se nuk ka plan hulumtimi, sepse ky dokument u është dërguar ekspertëve dhe sipas UMIB-it “nuk është analizuar në detaje”. Universiteti e vë theksin edhe te punimet e përbashkëta të stafit të programeve të ndryshme

studimore dhe të punimeve të stafit me studentët, për ta hedhur poshtë konstatimin se puna grupore kërkimore nuk inkurajohet.¹⁸

Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional

Komentin e ekspertëve se nuk ka doracakë që sqarojnë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e stafit, mundësitë e gradimit, e kështu me radhë, UMIB nuk e ka komentuar. Komenti i universitetit ka qenë se procedurat për punësimin e stafit akademik janë “të rregulluara në mënyrë unike” në burime të ndryshme si rregulloret e UMIB-it nga njëra anë dhe ligjet (të miratuara nga Kuvendi) dhe aktet nënligjore (të miratuara nga ministritë dhe Qeveria), nga ana tjetër. UMIB nuk e ka komentuar mungesën e stafit administrativ nga vendi i punës, por ka treguar se ka vlerësim vjetor për stafin administrativ në bazë të planit vjetor të personelit dhe se mban regjistra për këtë. Kjo është njëherësh edhe përgjigjja ndaj vlerësimit se UMIB-i nuk ka pasur procedurë rishikimi të vlerësimit të stafit.¹⁹

Menaxhimi i studentëve

Ndonëse AKA sugjeron se të dhënat për studentët në ndonjë rast mungojnë dhe nuk është vërtetuar se përdoren, ankesa përmend rrjetin online “Alumni” si dhe platformat Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL) dhe Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU). E para është përmendur në kontekstin e mundësisit të lidhjeve dhe ngjarjeve të “Alumnit” të mbajtura me të diplomuarit. Dy të tjerat janë përmendur në kontekstin e të dhënave që ekzistojnë. UMIB ka pohuar se këto 3 sisteme online i mundësojnë t’i gjejë “de-

tajet e nevojshme që shërbejnë si bazë për përmirësim.”²⁰

Burimet e Mësimin dhe Objektet

Në përgjigje ndaj vërejtjeve për objektet, universiteti shkruan se që nga nëntori 2018 ndodhet në objekte të reja dhe se tashmë e “posedon infrastrukturën më moderne në rajon”. Veç të tjerash, në ankesë shkruhet se ka bibliotekë funksionale dhe se qendra mjekësore është shumë afër me universitetin (500 metra). Në lidhje me 5 objektet e tjera, ankesa pohon se: konviktet janë në ndërtim e sipër, bufeja e studentëve është në procedurë të rregullimit ligjor në Këshillin Drejtues dhe planifikohet të jetë brenda hapësirës aktuale, dhe objektet sportive e rekreative janë në fazë të avansuar të projektimit.²¹

Bashkëpunimi institucional

Për ta dëshmuar bashkëpunimin me institucionet e tjera, UMIB e ka paraqitur krijimin e Bordit Këshillëdhënës për projektin “HERAS” të mbështetur nga një projekt i ADA-s austriake. Po ashtu, ka paraqitur kontratën e këtij projekti për themelimin e bordeve profesionale. Si prova shtesë të bashkëpunimit, universiteti i ka paraqitur marrëveshjet ndërkombëtare dhe vendore, dëshmitë e anëtarësisë në organizata ndërkombëtare dhe dëshmitë e organizimit të konferencave ndërkombëtare.²²

Për ta kuptuar më mirë situatën lidhur me Ankesën e UMIB-it ndaj KShC-së, zhvilluam një intervistë me Vjollca Krasniqin, zëvendëskryetare e KShC-së.

Ankesa e UMIB-it nuk është shqyrtuar për shkak se Komisioni i Ankesave (KA) i AKA-së ka dhënë dorëheqje më 27 gusht 2019. Ndërkohë, Udhëzimi Administrativ u lejon institucioneve të arsimit të lartë me vendime negative nga KShC-ja, që të riaplikojnë për akreditim institucional pas nëntëdhjetë ditëve. UMIB-i ka riaplikuar për akreditim institucional dhe në mbledhjet e 16 e 17 janarit 2020 KShC ka aprovuar aplikacionin e UMIB-it, krahas universiteteve të tjera. UMIB-i tani duhet ta dorëzojë raportin e vetëvlerësimit brenda afatit kohor prej tridhjetë ditësh, kurse AKA-ja pastaj duhet të ftojë ekipin e ekspertëve për vlerësim.

Arsyeja e dorëheqjes së KA-së vjen nga mospajtimi mbi mandatin dhe fuqinë vendimarrëse për çështje të akreditimit, të cilat kanë qenë në proces të ankimimit, si dhe për shkak të interpretimeve kontradiktore ligjore rreth mandatit të këtij Komisioni.

Për shkak të mospajtimeve rreth mandatit të KA-së, mes këtij dhe KShC-së, Avni Gashi, në atë kohë ushtrues detyre në AKA, kërkoi interpretim ligjor nga Ministria e Administratës Publike (MAP). Interpretimi i MAP-it mbështeti në Rregulloren e parë²³ sipas të cilës (neni 5) KA është organ i shkallës së dytë në AKA. Si rrjedhojë, KA ka vazhduar të punojë me këtë rregullore. Ndërkohë, KShC ka kërkuar interpretim ligjor prej MASHT-it dhe ka formuar një grup punues për rishikim të rregullores. Opinioni ligjor i MASHT-it mbështeti rregulloren e rishikuar rregulloren e rishikuar²⁴ dhe udhëzoi që kjo të merret për bazë. KA refuzoi opinionin ligjor të MASHT-it dhe paraqiti dorëheqje. I gjithë procesi ndodhi në periudhën prill-gusht 2019.

Pas dorëheqjes së KA-së, KShC shpalli se vendimet që ka marrë Komisioni janë të pavlefshme. Në vazhdim të kësaj, është draftu një letër për t'i njoftuar Institucionet e Arsimit të Lartë për këtë, por letra asnjëherë nuk është dërguar.

Përmes një emaili, në muajin shtator 2019 MASHT-i njoftoi KShC-në se tërhiqet prej interpretimit fillestar duke thënë se opinioni ligjor i MAP-it, që nënkupton rregulloren e parë, është i vlefshëm.²⁵



GJENDJA AKTUALE E STAFIT AKADEMIK

Fakulteti i Gjeoshkencave aktualisht ka gjithsej 28 pjesëtarë të stafit akademik me marrëdhënie të rregullt pune (24 burra e 4 gra), prej të cilëve 13 profesorë të rregullt, 6 profesorë të asocuar, 5 profesorë asistentë dhe 4 asistentë të rregullt. Moshë mesatare e profesorëve të rregullt është 56 vjeç, e profesorëve të asocuar 55.5 vjeç, e profesorëve asistentë 48 vjeç. Moshë mesatare e të gjithë profesorëve me angazhim të rregullt në Gjeoshkenca është 54 vjeç, ndërsa e asistentëve 33 vjeç. Brenda vitit 2020, dy profesorë e arrijnë moshën e pensionimit, njëri në Xehetari, tjetri në Metalurgji. Në Gjeoshkenca ka katër profesorë të angazhuar (të gjithë në Xehetari), por asnjë asistent të angazhuar. Në Gjeoshkenca ka katër profesorë të angazhuar (të gjithë në Xehetari), kurse nuk ka asnjë asistent të angazhuar. Moshë mesatare e katër profesorëve të angazhuar është 66 vjeç. Më i riu nga ta e arrin moshën 60 vjeçare brenda vitit 2020, ndërsa më i vjetri e arrin moshën 70 vjeçare — që rezulton me ndërprerje të angazhimit të tij.²⁶

²⁷

të rregullt BA dhe MA, që do të thotë se përpjesa profesor-student gjatë procesit të ligjëratave është 1:5. Nga këta 141 studentë, 113 ose 80% janë meshkuj dhe vetëm 28 ose 20% janë femra. Vetëm një student vjen nga komuniteti boshnjak.²⁸

Të gjithë anëtarët e stafit akademik të Gjeoshkencave i kanë përfunduar studimet BA brenda vendit. Shumica e stafit kanë kryer studimet MA brenda vendit (21 pjesëtarë ose 66%), ndërsa pjesa tjetër (11 pjesëtarë ose 34%) i kanë kryer studimet në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë dhe në Shqipëri. Nga 30 anëtarë me doktorata, 24 pjesëtarë ose 80% i kanë kryer studimet PhD në Kosovë e Shqipëri. Vetëm 6 pjesëtarë të stafit akademik ose 20% i kanë mbaruar studimet PhD jashtë vendit e në gjuhë të huaj dhe vetëm një PhD është nga vendet jashtë Ballkanit. Shumica dërrmuese i kanë përfunduar studimet të paktën në njërin nivel jashtë Kosovës (19 pjesëtarë ose 63%), kryesisht në Shqipëri dhe në vendet e ish-Jugosllavisë, ndërsa më pak (12 pjesëtarë ose 37%) kanë formim akademik krejtësisht vendor. Asnjë pjesëtar i stafit nuk i ka përfunduar të gjitha nivelet e studimit

Gjeoshkenca ka gjithsej 141 studentë



jashtë vendit dhe në gjuhë të huaj.²⁹

ANGAZHIMET, PENSIONIMET DHE KONKURSET PËR STAFIN AKADEMIK

Për të pasqyruar angazhimet e stafit akademik të Fakultetit të Gjeoshkencave për periudhën 2014/15 – 2018/19, kemi shqyrtuar listat e angazhimeve të rregullta e të jashtme të stafit akademik, pensionimet e profesorëve dhe konkurset për pozita të rregullta mësimdhënëse (profesorë të rinj, rishpallje dhe avancim të pozitive). Kemi shqyrtuar pozitat e shpallura për lëndët bazike të shkencave ekzakte (matematikë dhe fizikë), pavarësisht se këto nuk ndikojnë në akreditimin e programeve. Nga të dhënat e mësipërme paraqesim angazhimet, pensionimet dhe shpalljet e konkurseve për stafin akademik të Gjeoshkencave nëpër departamente, për periudhën 2015/16 – 2019/20:

- Në **xehetari** për çdo vit akademik kanë qenë vazhdimisht të angazhuar së paku pesë profesorë të rregullt, kurse asnjëherë nuk ka pasë më shumë se një asistent të angazhuar. Gjatë kësaj periudhe kanë qenë të angazhuar tre asistentë të rregullt dhe shtatë asistentë me honorar.
- Në **metalurgji** për çdo vit akademik kanë qenë vazhdimisht të angazhuar së paku shtatë profesorë të rregullt, kurse asnjëherë nuk ka pasë më shumë se dy asistentë të angazhuar. Gjatë kësaj periudhe kanë qenë të angazhuar katër asistentë të rregullt dhe gjashtë asistentë me honorar.
- Në **gjeologji** për çdo vit akademik kanë qenë vazhdimisht të angazhuar së paku tetë profesorë të rregullt, kurse asnjëherë nuk ka pasë më shumë se dy asistentë të angazhuar. Gjatë kësaj periudhe kanë qenë të angazhuar shtatë asistentë të rregullt dhe trembëdhjetë asistentë me honorar.
- Për **lëndë e përgjithshme** gjatë kësaj periudhe ka qenë i angazhuar vetëm një profesor i rregullt, në vitin akademik 2019/20, ndërsa çdo vit ka qenë i angazhuar një asistent i rregullt. Gjatë kësaj periudhe kanë

Programi Xehetari

Viti akademik	Staf i rregullt		Staf i angazhuar	
	Profesorë të rregullt	Asistentë	Profesorë të rregullt	Asistentë
2015/16	9	0	5	3
2016/17	5	0	4	0
2017/18	8	1	4	2
2018/19	8	1	6	2
2019/20	5	1	4	9

Programi Gjeologji

Viti akademik	Staf i rregullt		Staf i angazhuar	
	Profesorë të rregullt	Asistentë	Profesorë të rregullt	Asistentë
2015/16	8	2	2	4
2016/17	8	2	3	0
2017/18	8	1	1	4
2018/19	8	2	0	5
2019/20	11	0	0	0

Programi Materiale dhe Metalurgji				
Viti akademik	Staf i rregullt		Staf i angazhuar	
	Profesorë të rregullt	Asistentë	Profesorë të rregullt	Asistentë
2015/16	12	0	2	4
2016/17	12	0	1	2
2017/18	10	1	4	0
2018/19	8	1	5	0
2019/20	7	2	0	0

Lëndë të përgjithshme				
Viti akademik	Staf i rregullt		Staf i angazhuar	
	Profesorë të rregullt	Asistentë	Profesorë të rregullt	Asistentë
2015/16	0	1	1	3
2016/17	0	1	1	3
2017/18	0	1	1	2
2018/19	0	1	1	1
2019/20	1	1	0	0

qenë të angazhuar katër profesorë dhe nëntë asistentë me honorar.

janë pensionuar 6 profesorë gjatë kësaj periudhe, njëri prej të cilëve është duke e vazhduar angazhimin, kurse 5 të tjerë e kanë ndërprerë angazhimin.³¹

Gjatë periudhës 2014/15 – 2018/19 janë shpallur gjashtë konkurse për angazhimin e stafit të rregullt akademik, katër konkurse për angazhimin e personelit akademik me honorar, kurse në vitet 2014 dhe 2015 nuk ka pasur konkurse. Në konkurset për angazhimin e stafit akademik janë shpallur pozitat për 18 profesorë të rregullt dhe pesë asistentë, si dhe dy pozita për profesorë me honorar dhe 17 për asistentë me honorar.³⁰

Në periudhën 2015/16 – 2019/20 në gjeologji e kanë ndërprerë angazhimin dy profesorë, ndërsa nuk ka profesorë të pensionuar. Në xehetari janë 8 profesorë të pensionuar. Prej tyre 4 janë të angazhuar, 3 janë që e kanë ndërprerë angazhimin (vitin 2016 e 2017) dhe një që ndërpret angazhimin në vitin 2020. Në metalurgji

Për të pasqyruar angazhimet e stafit akademik të Fakultetit të Gjeoshkencave për periudhën 2014/15 – 2018/19, kemi shqyrtuar listat e angazhimeve të rregullta e të jashtme të staft akademik, pensionimet e profesorëve dhe konkurset për pozita të rregullta mësimdhënëse (profesorë të rinj, rishpallje dhe avancim të pozitive).


INTERESIMI, VËSHTIRËSITË DHE SUKSESET NË STUDIME

Hulumtuam pasqyrat e numrave të studentëve të regjistruar nëpër vitet akademike në nivelet BA e MA, përfshirë këtu edhe raportin gjinor, dhe rezultatet e konkurseve për bursa nga UMIB-i, për ta evidentuar interesimin e të rinjve për studime në programet e Gjeoshkencave gjatë periudhës 2014/15–2018/19, por edhe vështirësitë dhe suksesin e tyre gjatë studimeve.

Regjistrimi i studentëve të rinj

Në kuadër të UMIB-it, Fakulteti i Gjeoshkencave shfaqet me numrin më të vogël të regjistrimit të studentëve të rinj për periudhën 2014/15–2018/19, kurse në kuadër të tij, programi **Materiale dhe Metalurgji** del me regjistrimin më të vogël të studentëve të rinj. Të gjitha programet në këtë fakultet kanë shënuar gati përgjysmim në vitin akademik 2016/17, kurse rënie drastike në vitin akademik 2018/19.³²

Regjistrimet e studentëve në programe³⁴




Aplikimet, regjistrimet dhe diplomimet e studentëve në BA dhe MA

Nga pasqyrat e numrit të studentëve të diplomuar nëpër vitet akademike shihet se gjatë periudhës 2014/15 - 2018/19 në të gjitha drejtimet e Fakultetit të Gjeoshkencave, përqindja e të diplomuarve është shumë e vogël në raport me numrin e të regjistruarëve:


- Në **materiale dhe metalurgji**, prej 178 studentëve që kanë regjistruar studimet, vetëm 20 studentë ose 11%, kanë diplomuar.
- Në **gjeologji**, prej 295 studentëve që kanë regjistruar studimet, vetëm 37 ose 12.5%, kanë diplomuar.
- Në **xehetari**, prej 229 studentëve që kanë regjistruar studimet, vetëm 41 ose 18%, kanë diplomuar.

Në tabelat më poshtë janë të paraqitura të dhënat mbi numrin e aplikimeve, regjistrimeve dhe diplomimeve nëpër programe studimi për periudhën 2014-2019:


Programi Materiale dhe Metalurgji (BA)



Programi Xehetari (BA)



Programi Gjeologji (BA)




Të dhënat e studentëve të regjistruar nëpër vite akademike tregojnë se interesimi më i madh i studentëve ka qenë për programin e gjeologjisë, kurse suksesi më i lartë, duke iu referuar diplomimit të studentëve, ka qenë në programin e xehetarisë.

Nga pasqyrat për studimet MA për periudhën 2014/15–2018/19, shihet se regjistrimet dhe diplomimet e studentëve kanë qenë stabile dhe pa luhatje të mëdha.

Nga 25 studentë të cilët kanë regjistruar studimet në **metalurgji**, 6 studentë ose 24%, kanë diplomuar. Nga 37 studentë të regjistruar në **xehetari**, 28 studentë ose 77%, kanë diplomuar; nga 33 studentë të regjistruar në **burimet e lëndëve të para minerale**, 10 studentë ose 30%, kanë diplomuar; kurse nga 30 studentë të regjistruar në **hidrogjeologji dhe gjeologji inxhinierike**, 10 studentë ose 33.5% kanë diplomuar.


Regjistrimet e studentëve nëpër programe, MA



Vërehet se xehetaria është programi me interesimin dhe suksesin më të lartë në studime, për shkak se prin jo vetëm me numrin e regjistrimeve gjatë periudhës 2014/15–2018/19, por edhe me numrin e

të diplomuarve në raport me regjistrimet. Nga programet e Gjeoshkencave, ai i **metalurgjisë** ka numrin më të vogël të regjistrimeve dhe të të diplomuarve.

Diplomimet e studentëve nëpër programe, MA³⁵



Bursat

Në periudhën 2015/16–2019/20 numri i studentëve të UMIB-it të të gjitha fakulteteve që kanë fituar bursë nga ky institucion është 285. Fakulteti i Gjeoshkencave ka numrin më të vogël të bursistëve ndër vite me 21 bursa në total ose 7.37%.

Shuma e vlerave të bursave në UMIB gjatë kësaj periudhe është 190,666.00€, kurse për Gjeoshkenca 17,106.00€, që i bie 9% e shumës totale. FTU prin me numrin më të madh prej 64 studentëve bursistë në vlerë prej 56,409.00€.

Studentët e Gjeoshkencave, të FTU-së dhe FIMK-ut duhet t'i kenë të përfunduara të gjitha provimet e vitit të dytë me notë

mesatare mbi 8, për dallim nga studentët e fakulteteve të tjera, të cilëve u kërkohet të kenë notë mesatare mbi 9, gjë që tregon për vështirësitë në kryerjen e studimeve.

Në vitin akademik 2014/15 UMIB ka ndarë 24 bursa në vlerë prej nga 800€, që i bie se shuma totale e vlerave të bursave për periudhën 2014/15–2019/20 është 209,866.00€.³⁵

Numri i burasve sipas fakulteteve³⁷



7.37% Gjeoshkenca

22.46% FTU

19.30% FIMK

17.19% Edukimi

19.30% Juridiku

14.40% Ekonomiku

GJENDJA SIPAS PROFESORËVE

Nga intervistat e realizuara me pjesëtarë të stafit të rregullt akademik të Fakultetit të Gjeoshkencave, rezulton se institucionit i UMIB-it është ndikuar rëndë nga mosakreditimi, sidomos programet e gjeoshkencave.

Sipas të intervistuarve, heqja e akreditimit ka ndikuar në reputacionin e UMIB-it si Institucion i Arsimit të Lartë (IAL), duke ua pamundësuar regjistrimin studentëve të rinj dhe duke ua humbur besimin për studime të mirëfillta në UMIB. Kjo bëhet veçanërisht shqetësuese kur të kihet parasysh se Fakulteti i Gjeoshkencave është i vetmi i profilit të drejtimeve minerare në Kosovë³⁷. Sipas dekanit Naser Peci³⁸, pasojat e mosakreditimit do të jenë zinxhirore për gjeoshkencat, kurse sipas profesor Nazmi Hasi ky refleksion negativ do të vijojë për plot tre vjet të tjerë.³⁹

Gjysma e profesorëve të intervistuar pajtohen plotësisht me gjetjet e raportit të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit

dhe me vendimin e KShC-së. Të gjithë këta profesorë konsiderojnë përgjegjës Rektoratin e UMIB-it për heqjen e akreditimit dhe vlerësojnë se ky i fundit do të duhej të jepte përgjegjësi morale, madje edhe dorëheqje. Profesi Nazmi Hasi thotë se gjetjet e ekipit të ekspertëve kanë qenë reale dhe se pajtohet me epilogun e tyre. Ai sqaron se vërejtjet e ekspertëve kanë qenë të adresuara drejt menaxhmentit dhe rektoratit të UMIB-it, konkretisht te prorektori për mësimdhënie dhe çështje të studentëve, dhe shton se menaxhmenti paraprak i UMIB-it ka pasur defekte serioze profesionale e menaxheriale.⁴⁰ Lidhur me këtë, profesori Sylejman Hyseni thotë se po mungon përgjegjësia dhe se Rektorati e Këshilli Drejtues janë të politizuar,⁴¹ kurse profesori Afrim Koliqi thotë se UMIB-i është nën ndikimin e një partie politike, e edhe të klaneve të caktuara. Ndonëse Fakulteti i Gjeoshkencave ka traditë të kahershme, pjesën më të madhe të universiteteve

dhe të kolegjeve i ka krijuar politika dhe si të tilla janë universitete dhe kolegje elektorale, përfundon ai.⁴²

Lidhur me vlerësimin e ekspertëve për UMIB-in, profesor Behxhet Shala, prorektor për bashkëpunim ndërkombëtar, thotë se “gjetjet janë reale, por kriteret nuk janë në harmoni me kushtet, mundësitë dhe statutin e universitetit”⁴³. Në vazhden e kësaj, profesori Sabri Avdullahi, koordinator për zhvillim akademik në gjeoshkenca, nuk pajtohet me gjetjet e raportit sepse pohon që standardet kanë qenë të larta, prandaj kriteret e kërkuara vështirë që ndonjë universitet në nivel vendi do të mund t’i plotësojë⁴⁴.

Të gjithë të intervistuarit pajtohen se përgjithësisht ka rënie të interesimit të studentëve, e kjo për shkak të mosfunksionimit të industrisë. Pra, mungesa e vendeve të punës për të diplomuarit e këtyre programeve ka rezultuar në rënie të numrit të regjistrimeve në këtë fakultet. Profesor Sylejman Hyseni tregon se ka kohë që diskutohet në kuadër të gjeoshkencave për rrezikun e shuarjes së këtij fakulteti si pasojë e mosinteresimit të studentëve⁴⁵. Profesor Muharrem Zabeli, prodekan në gjeoshkenca, thotë se rënia e interesimit është drejtpërdrejt e lidhur me industrinë, dhe se me vetëm pak investim në zhvillim të industrisë, përkatësisht të Trepçës, rritet menjëherë numri i studentëve në këtë fakultet.⁴⁶

Veç mungesës së perspektivës për të diplomuarit e gjeoshkencave, shkaktarë të tjerë janë vështirësitë për t’i përfunduar studimet në këtë fakultet dhe migrimi. Për

këtë, të intervistuarit theksojnë nevojën e profilizimit të programeve në kuadër të universitetit, krijimin e programeve të reja në kuadër të gjeoshkencave, si dhe nevojën e incentivave për të nxitur studentët të studiojnë drejtime teknike.

Profesori Nazmi Hasi thotë se duhet evituar dualizimi i fakulteteve. Fakultetet e tjera të UMIB-it si Edukimi, Juridiku dhe Ekonomiku janë më tërheqëse për studentët, por meqë këto fakultete e drejtime gjenden edhe në kuadër të UP-së, si dhe duke pasur parasysh se universiteti ka një traditë të pasur nga shkencat teknike metalurgjike nga e kaluara, është e rëndësishme që t’i kthehet profili i tij teknik⁴⁷. Lidhur me këtë, profesor Izet Ibrahim thotë se UMIB-i ka nevojë të profilizohet dhe të orientohet në programet teknike, “për të cilat stafi akademik ka traditë të shkëlqyer dhe konsistencë për disa dekada”⁴⁸. Kjo, beson ai, do ta bënte UMIB-in lider në rajon. Ngjashëm mendon edhe profesori Afrim Koliqi, sipas të cilit një ose dy universitete të mirëfillta e të profesionalizuara në vend do të mjaftonin. Sipas tij, duen profile që e zhvillojnë ekonominë e vendit, e jo shtatë-tetë të njëjta, sepse Kosova është vend i vogël për të pasur Fakultet Juridik në secilin qytet.⁴⁹

Në vazhden e kësaj, profesori Sabri Avdullahi bën me dije se po punohet për krijimin e programeve të reja për me qenë në trend me kohën dhe njëkohësisht për ta bërë këtë fakultet më atraktiv për studentët.⁵⁰ Pikërisht për këtë tregon se UMIB-i është duke bashkëpunuar me



universitetet e Shqipërisë dhe Polonisë. Rektori Alush Musaj thotë se së shpejti do të hapen programe të specializuara në kuadër të gjeoshkencave, në mënyrë që të jenë në hap me kohën dhe të tërheqin studentë në programet teknike.⁵¹

Të gjithë të intervistuarit konfirmuan nevojën e incentivave për studentët aktualë dhe potencialë të gjeoshkencave, për shkak të vështirësive në kryerjen e studimeve në këto drejtime, si dhe për shkak të rëndësisë së këtij sektori për ekonominë e vendit. Sipas profesorit Izet Ibrahimimi, shkencat teknike gjithmonë janë konsideruar më të vështira për t'u përfunduar me sukses dhe njëkohësisht ekziston përceptimi se me përfundimin e

studimeve në ekonomik ose edukim mund të arrihet më lehtë punësimi.⁵² Duke e pasur parasysh se punësimi në këtë sektor shumicën e rasteve nënkupton punë në terren e miniera, është e natyrshme që studentët të preferojnë të përfundojnë juridikun, ekonomikun a edukimin në mënyrë që të kenë një punë në zyrë.⁵³ Sa i përket stimulimit përmes bursave, profesor Sabri Avdullahi tregon se kanë kërkuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) që të ndajë nga dhjetë bursa në vit për studentë të gjeoshkencave, dhe ndonëse kjo u është premtuar, asnjëherë nuk është realizuar⁵⁴. Kurse Profesor Kemajl Zeqiri, njëherit anëtar i bordit të KPMM-së, rekomandon që të ketë praktika me pagesë

për studentë dhe të ketë stimulim meritore për vijuesit e këtyre drejtimeve.⁵⁵

Në rast se mbyllet Fakulteti i Gjeoshkencave, pasojat do të ishin katastrofale për zhvillimin dhe ekonominë e vendit. Sipas të intervistuarve, nëse do të mbylleshin drejtimet teknike si xehetaria, teknologjia, gjeologjia, metalurgjia, e me radhë, Kosova do të duhej të importonte profesionistë nga jashtë për këto fusha.⁵⁶ Sipas profesorit Zenun Elezaj, Fakulteti i Gjeoshkencave duhet gjithsesi të mbijetojë për shkak se është i vetmi në nivel vendi që përgatit kuadro për sektorin minerar, i cili konsiderohet bazë për zhvillimin ekonomik në të ardhmen.⁵⁷

Fakulteti i Gjeoshkencave dhe ndërmarrjet minerare

Me qëllim që të sqarojmë se cila është rëndësia e Fakultetit të Gjeoshkencave në industri dhe ta paraqesim gjendjen aktuale të ndërmarrjeve lidhur me kuadrot inxhinierike, kemi intervistuar përfaqësuesit e katër ndërmarrjeve më të mëdha të sektorit minerar. Nga dy ndërmarrje publike minerare – Trepça dhe KEK-u, dhe dy ndërmarrje private – NewCo Ferronikel-i dhe Sharrcem-i, i kemi kërkuar të dhënat për:

- Sfidat kryesore lidhur me kuadrot e reja profesionale;
- Kuadrot profesionale që u mungojnë;
- Numrin aktual të inxhinierëve të punësuar, profilet inxhinierike dhe moshën mesatare të tyre;
- Numrin e të diplomuarve nga UMIB dhe universitetet e tjera, të

punësuar gjatë 10 viteve të fundit, si dhe profilet e tyre;

- Numrin e studentëve të UMIB dhe të universiteteve të tjera që kanë kryer praktika profesionale në ndërmarrje dhe profilet profesionale të tyre;
- Numrin e praktikantëve të punësuar nëpër ndërmarrje nga UMIB dhe nga universitetet e tjera gjatë 10 viteve të fundit dhe profilet e tyre;
- Numrin e studentëve për të cilët ndërmarrjet kanë ndarë bursa dhe shumat e bursave për secilin universitet;
- Numrin e studentëve të UMIB që kanë marrë bursa nga ndërmarrjet, numrin e tyre për secilin fakultet teknik të UMIB-it dhe shumën financiare të tyre;
- Bashkëpunimin me UMIB dhe format e bashkëpunimit të ndërmarrjeve me të;
- Anëtarësinë në Bordin Këshillëdhënës të UMIB dhe dijeninë e ndërmarrjeve për ekzistimin e tij;

KEK

KEK-u ka mbi 4 mijë të punësuar, prej të cilëve 365 inxhinierë. Moshja mesatare e punonjësve është rreth 56 vjeç. Si inxhinierët, ashtu edhe e të punësuarit e tjerë kanë moshë të lartë mesatare, dhe sipas KEK-ut, kjo është sfida kryesore e ndërmarrjes në raport me kuadrot profesionale. Nevojat për kuadro të reja inxhinierike i sugjeron fakti se gjatë periudhës 2010-2019, trendi i pensionimit

ka qenë më i fortë se trendi i punësimit. Në 10 vitet e fundit janë pensionuar 144, ndërsa janë punësuar 112. Kjo do të thotë se në këtë periudhë dhjetëvjeçare numri i inxhinierëve të KEK është ulur për 32.

Edhe në dhjetëvjeçarin e ardhshëm (në periudhën 2019-2029) pritet të pensionohen rreth 205 inxhinierë. Aktualisht, KEK-u ka nevojë për të diplomuar nga Gjeoshkenca (inxhinierë të Xehetarisë) dhe inxhinierë të Termoenergjetikës, Elektroenergjetikës, Elektronikës dhe Makinerisë (që vijnë nga fakultete të tjera). Ndërmarrja nuk posedon të dhëna të të punësuarve dhe praktikantëve, të ndara sipas universiteteve dhe programeve në të cilat të punësuarit i kanë kryer studimet. As politika të tjera të afrimit të kuadrove me ndërmarrjen nuk ka pasur, duke e marrë për bazë faktin se KEK nuk ka ndarë bursa dhe nuk i ka kompensuar 310 praktikantët që i ka pasur gjatë periudhës 2010-2019.^{58 59}

Trepça

Trepça aktualisht ka 1215 të punësuar, prej të cilëve 55 janë inxhinierë. Prej tyre 30 janë të profileve të gjeoshkencave (11 të Xehetarisë, 9 të Gjeologjisë dhe 5 të Metalurgjisë), ndërsa të tjerët janë të profilit të elektroteknikës (12) dhe të Mekanikës (18). Mosha mesatare e inxhinierëve është rreth 50 vjeç. Gjatë 10 viteve të fundit në Trepçë janë pensionuar 23 inxhinierë, ndërkaq për 10 vitet e ardhshme pritet të pensionohen 21 inxhinierë.⁶⁰ Për shkak të kuadrit me moshë mbi 50 vjeç dhe kohës që nevojitet për përgatitje, sipas ekspertëve

dhe Trepçës “është koha e fundit” për punësimin e inxhinierëve të rinj.^{61 62}

Edhe aktualisht ndërmarrja përballet ka mungesë kadroshe të të gjitha programeve të Gjeoshkencave (Xehetarisë, Gjeologjisë dhe Metalurgjisë), Elektroenergjetikës dhe Makinerisë. Në 10 vitet e fundit Trepça ka punësuar vetëm të diplomuar nga FXM, Fakulteti i Gjeoshkencave dhe FIMK. Ndërmarrja nuk është pjesë e Bordit Këshillëdhënës të UMIB dhe bordi nuk është strukturë e njohur për të. Megjithatë Trepça i ka mirëpritur praktikantët, ajo nuk ka pasur politika nxitëse për studentët dhe të diplomuarit e UMIB siç janë kompensimi i praktikave ose ndarja e bursave studimore në fushat që i arsimojnë inxhinierët për nevojat e saj.⁶³

KPMM, punësimi dhe ndërmarrjet

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) është agjenci e pavarur që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Disa nga rolet kryesore që i kryen janë lëshimi dhe inspektimi i licencave (për hulumtim dhe, shfrytëzim të burimeve minerare). Gjysma e të punësuarve në KPMM (33 nga 76) janë inxhinierë të profileve të ndryshme të shkencave të tokës. Prej tyre 17 janë inxhinierë të Gjeologjisë, 12 të Xehetarisë, 2 inxhinierë të Elektrikës, 2 të Gjeodezisë dhe një i Teknologjisë. Shumica e tyre janë nga FXM pasi që i kanë kryer studimet në fillim të viteve 2000. KPMM nuk ka dhënë asnjëherë prakika me pagesë dhe sipas ekspertëve të saj nuk ka bazë ligjore për këtë që rezulton edhe në mosorientimin e mjeteve financiare për praktika me pagesë. Propozimi i

tyre për zgjidhjen e kësaj çështjeje është nxjerrja e një udhëzimi administrativ për kompensim të praktikave nga MZHE.

Ndërmarrjet publike dhe punësimi

Ekspertët e KPMM janë të shqetësuar për mospërtëritjen e punëtorëve, si të minatorëve, ashtu edhe të inxhinierëve në KEK dhe në Trepça. Njëri nga rekomandimet e tyre është investimi në sektorin minerar, duke e përfshirë Trepçën, sepse do ta hapte rrugën drejt punësimit të kuadrove të reja inxhinierike. Vlerësimi i tyre është se investimet në këtë ndërmarrje janë më të lehta, sepse me Ligjin për Trepçën, të miratuar në vitin 2016, është hapur rruga si për investime më të mëdha publike, ashtu edhe për privatizimin e saj.

Sektori privat dhe punësimi

Sektori minerar i ka në total 665 ndërmarrje të licencuara. Gjatë vitit 2019 janë licencuar 255 ndërmarrje—118 për aktivitete të veçanta 85 për hulumtim dhe 52 për shfrytëzim të burimeve minerare.

Megjithatë, sektori minerar ka ndërmarrje të shumta të paregjisturara. Përgjatë inspektimeve të KPMM vitin 2019,

192 ndërmarrje kanë rezultuar pa licenca.⁶⁴ Ekspertët e KPMM-së vlerësojnë se përveç dëmit mjedisor⁶⁵, ndërmarrjet pa licencë shkaktajnë edhe dëm në punësimin e kuadrove të Gjeoshkencave, pasi që nuk punësojnë inxhinierë. Secila ndërmarrje e regjistruar është e obliguar që ta punësojë të paktën një inxhinier nga profilet që i prodhon Fakulteti i Gjeoshkencave. Sipas ekspertëve, me një përlllogaritje të thjeshtë, del se me licencimin e 192 ndërmarrjeve të reja minerare punësohen të paktën 192 inxhinierë të profileve të Gjeoshkencave.^{66 67}

Nga intervistat e realizuara me pjesëtarë të stafit të rregullt akademik të Fakultetit të Gjeoshkencave, rezulton se institucioni i UMIB-it është ndikuar rëndë nga mosakreditimi, sidomos programet e gjeoshkencave.

PËRFUNDIME

- Fakulteti i Gjeoshkencave ka gjithsej 28 pjesëtarë të stafit akademik (24 burra e 4 gra). Moshë mesatare e profesorëve të rregullt është 56 vjeç; e profesorëve të asocuar 55.5; e profesorëve asistentë 48; në total, moshë mesatare e profesorëve me angazhim të rregullt është 54 vjeç. Përpjesa profesor-studentë gjatë procesit të ligjëratave është 1:5. Asnjë pjesëtar i stafit nuk i ka mbaruar studimet BA jashtë vendit e në gjuhë të huaj, kurse vetëm 34% i kanë kryer studimet MA në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë dhe në Shqipëri. Asnjë pjesëtar i stafit nuk i ka mbaruar të gjitha nivelet e studimit jashtë vendit e në gjuhë të huaj. Studimet PhD vetëm 6 pjesëtarë të stafit akademik i kanë mbaruar jashtë vendit e në gjuhë të huaj.
- Në secilin program studimi për periudhën 2015/16 – 2019/20, në total kanë qenë të angazhuar më shumë asistentë me honorar sesa të rregullt: në xehetari 3 asistentë të rregullt e 7 me honorar, në metalurgji 4 asistentë të rregullt e 6 me honorar dhe në gjeologji 7 asistentë të rregullt e 13 me honorar. Gjatë kësaj periudhe ka rënie në numrin e profesorëve të rregullt në xehetari dhe metalurgji, kurse në gjeologji numri i profesorëve të rregullt ka qenë konstant, deri në vitin akademik 2019/20, me ç'rast ka një ngritje të lehtë.
- Gjatë periudhës 2014/15–2018/19 janë shpallë gjashtë konkurse për angazhimin e stafit të rregullt akademik, në të cilat janë kërkuar gjithsej 18 profesorë dhe 5 asistentë. Po ashtu, janë shpallë katër konkurse për angazhimin e personelit akademik me honorar, ku janë kërkuar gjithsej 2 profesorë dhe 17 asistentë.
- Fakulteti i Gjeoshkencave, në kuadër të UMIB-it, shfaqet me numrin më të vogël të regjistrimit të studentëve të rinj në periudhën 2014/15–2018/19. Në kuadër të Gjeoshkencave, programi Materiale dhe Metalurgji del me regjistrimin më të vogël të studentëve të rinj. Të gjitha programet në këtë fakultet kanë rënie drastike të numrit të studentëve gjatë kësaj periudhe. Arsyeja kryesore e rënies së numrit të studentëve është mosfunksionimi i industrisë. Përveç mungesës së perspektivës për të diplomuarit e gjeoshkencave, shkaktarë të tjerë janë vështirësitë për t'i përfunduar studimet në këtë fakultet dhe migrimi.
- Gjatë periudhës 2014/15–2018/19, në të gjitha programet studimore BA, përqindja e të diplomuarve është shumë e vogël në raport me numrin e të regjistruarve. Nga 178 studentë të regjistruar në materiale dhe metalurgji, vetëm 20 studentë, ose

11%, kanë diplomuar. Në gjeologji, nga 295 studentë të regjistruar, vetëm 37 ose 12.5%, kanë diplomuar. Xehetaria ka numrin më të lartë të të diplomuarëve, ku nga 229 të regjistruar, 41 ose 18%, kanë diplomuar.

- Gjatë periudhës 2014/15–2018/19 në të gjitha programet studimore MA, regjistrimet dhe diplomimet e studentëve kanë qenë stabile dhe pa luhatje të mëdha. Nga 25 studentë të regjistruar në metalurgji, 6 ose 24% kanë diplomuar; nga 37 studentë të regjistruar në xehetari, 28 ose 77% kanë diplomuar; nga 33 studentë të regjistruar në burimet e lëndëve të para minerale, 10 ose 30% kanë diplomuar; dhe nga 30 studentë të regjistruar në hidrogeologji dhe gjeologji inxhinierike, 10 ose 33.5% kanë diplomuar.
- Xehetaria prin jo vetëm me numrin e regjistrimeve për periudhën 2014-2019, por edhe me numrin e të diplomuarve në raport me regjistrimet. Metalurgjia paraqitet me numrin më të vogël të regjistrimeve dhe të diplomuarve.
- Në periudhën 2015/16–2019/20 numri i studentëve nga të gjitha fakultet e UMIB-it që kanë fituar bursë nga ky institucion është 285, kurse Fakulteti i Gjeoshkencave ka numrin më të vogël të bursistëve me gjithsej 21 bursa ose 7.37%. Shuma totale e vlerave të bursave në UMIB gjatë periudhës 2014-2019 është 190,666.00€, kurse për Gjeoshkenca 17,106.00€, që i bie 9% e shumës totale.
- Raporti gjinor në nivelin BA është 80% studentë e 20% studente. Në nivelin MA është 85% studentë e 15% studente.
- Më 15 korrik 2019 AKA-ja vendosi t'ia heqë akreditimin institucional UMIB-it për mosplotësimin ose plotësimin e pjesshëm të kapitujve të Manualit për Akreditim. Një nga 11 kapitujt e këtij manuali (Standardi për Planifikim Strategjik, Qeverisja dhe Administrimi) nuk ishte plotësuar fare. Heqja e akreditimit është rreziku më i madh me të cilin është përballur ndonjëherë UMIB-i, për shkak se në rast të dështimit për akreditim institucional për herë të dytë, i hiqet licenca.
- UMIB-i është ankuar për heqjen e akreditimit më 7 gusht 2019, me pretendimin se vendimi i KShC-së është nxjerrë me shkeljen e dispozitave lidhur me procedurën e marrjes së vendimit, me konstatimin e gabuar të gjendjes faktike dhe me zbatimin e gabuar të ligjit dhe të rregullave të zbatueshme.
- Ankesa e UMIB-it nuk është shqyrtuar për shkak se Komisioni i Ankesave (KA) të AKA-së ka dhënë dorëheqje më 27 gusht 2019. AKA-ja vazhdon të mos ketë KA. Arsyeya e dorëheqjes së KA-së është mospajtimi mbi mandatin dhe fuqinë

vendimarrëse për çështje akreditimi mes saj dhe KShC-së, si dhe për shkak të interpretimeve kontradiktore ligjore rreth mandatit të Komisionit.

Nga intervistat e realizuara me pjesëtarë të stafit të rregullt e të angazhuar akademik të Fakultetit të Gjeoshkencave, por edhe me menaxhmentin e Gjeoshkencave, rezulton se:

- Mosakreditimi institucional e ka ndikuar rëndë UMIB-in, sidomos programet e gjeoshkencave. Heqja e akreditimit ka dëmtuar reputacionin e UMIB-it, duke pamundësuar regjistrimin e studentëve të rinj dhe duke ua humbur besimin në studime të mirëfillta në UMIB.
- Gjysma e profesorëve të intervistuar pajtohen me gjetjet e raportit të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit dhe me vendimin e KShC-së, duke e konsideruar përgjegjës rektoratin e UMIB-it për heqjen e akreditimit. Pjesa tjetër nuk pajtohet me gjetjet e raportit për shkak se kriteret nuk janë në harmoni me kushtet, mundësitë dhe statutin e universitetit.
- Ka rënie të interesimit të studentëve për të ndjekur studimet në Gjeoshkenca, arsyeja kryesore duke qenë mosfunksionimi i industrisë. Përveç mungesës së perspektivës, shkaktarë të tjerë janë vështirësitë për t'i përfunduar studimet, si dhe migrimi.
- Po qe se mbyllet Fakulteti i Gjeoshkencave në UMIB, pasojat do të jenë katastrofale për shkak se është i vetmi fakultet në nivel vendi që përgatit kadro për sektorin mineral, që është bazë për zhvillimin ekonomik të vendit.

Nga ndërmarrjet dhe institucionet e marra në shqyrtim – KEK, TREPÇA dhe KPMM – rezulton se:

- Bordi Këshillëdhënës është joefektiv sa i përket lidhjes së Fakultetit të Gjeoshkencave me industrinë. Për drejtues të ndërmarrjeve publike dhe për anëtarë të stafit akademik, nuk është strukturë e njohur.
- KEK dhe Trepça kanë nevojë të përtërijnë kuadrin me inxhinierë të rinj duke përfshirë edhe inxhinierë të Gjeoshkencave.
- KEK dhe Trepça nuk janë anëtarë të Bordit Këshillëdhënës të UMIB. Duhet theksuar se ka edhe anëtarë të stafit akademik që nuk janë në dijeni për bordin dhe punën e tij.
- Ndërmarrjet minerare pa licencë, përveç dëmit mjedisor, kanë ndikim negativ në punësimin e kuadrove të Gjeoshkencave.
- NewCo Ferronikeli dhe SharrCem nuk janë përgjigjur në pyetjet e Admovere.

Referencat

- 1 Vendimi për Akredim Nr.1356/19D, 29 korrik 2010, Prishtinë; Mund të shkarkohet nga kategoria “Vendimi i AKA-së – Institucional dhe programet e studimit (29.07.2019)” në vegëzën: <https://www.umib.net/vendimet-per-akreditim/>.
- 2 “Reagim ndaj vlerësimit të njëanshëm dhe tendencioz të paraqitur në raport të akreditimit institucional ndaj Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini””, 18 qershor 2019; Nga vegëza: <https://www.umib.net/reagim-ndaj-vleresimit-te-njeanshem-dhe-tendencioz-te-paraqitur-ne-raport-te-akreditimit-institucional-ndaj-universitetit-te-mitrovices-isa-boletini/>.
- 3 “Kosnett me reagime të njëpasnjëshme për cilësinë e arsimit: Vendim korrekt mosakreditimi i universiteteve”, Klankosova.tv, Nga vegëza: <https://klankosova.tv/kosnett-me-reagime-te-njepasnjeshe-per-cilesine-e-arsimit-vendim-korrekt-mosakreditimi-i-universiteteve/>.
- 4 “50 vjet të Fakultetit Shkencave të Aplikuara – 1961-2011 – (Monografi)”, Grup autorësh, Avdi Salihu kryeredaktor, Universiteti i Prishtinës, Mitrovicë, 2012.
- 5 Në këto objekte sot është i vendosur “Universiteti i Prishtinës” që vepron në serbisht për komunitetin serb.
- 6 Historiku, faqja e UMIB, Nga vegëza: <https://www.umib.net/historiku/>.
- 7 Vendimi për Akredim Nr.1356/19D, faqe 2, 29 korrik 2010, Prishtinë; Mund të shkarkohet nga kategoria “Vendimi i AKA-së – Institucional dhe programet e studimit (29.07.2019)” në vegëzën: <https://www.umib.net/vendimet-per-akreditim/>.
- 8 Ibid faqe 3
- 9 Ibid faqe 4
- 10 Ibid faqe 5
- 11 Ibid faqe 5
- 12 “Ankesa e Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” drejtuar KSHC/AKA lidhur me vendimin e datës 29.07.2019”, faqe 3 dhe 4, Faqja e UMIB, Mund të shkarkohet në kategorinë “Kliko këtu” nga vegëza: <https://www.umib.net/ankesa-e-universitetit-te-mitrovices-isa-boletini-drejtuar-kshc-aka-lidhur-me-vendimin-e-dates-29-07-2019/>.
- 13 Ibid faqe 5
- 14 Ibid faqe 6-8
- 15 Ibid faqe 8 dhe 9
- 16 Ibid faqe 10
- 17 Ibid faqe 11-13
- 18 Ibid faqe 13,4
- 19 Ibid faqe 15,16

- 20 Ibid faqe 16,17
- 21 Ibid faqe 17,18
- 22 Ibid faqe 18,19
- 23 Rregullorja gjendet në http://akreditimi-ks.org/docs/LawRegulation/Rregullorja_e_komisionit_te_ankesaveOLD.pdf
- 24 Rregullorja e rishikuar gjendet në http://akreditimi-ks.org/docs/LawRegulation/Rregullorja_e_komisionit_te_ankesave.pdf
- 25 Intervistë me Vjollca Krasniqin, Zv. Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë së AKA-së, 31.01.2020.
- 26 Listë e dërguar përmes emailit, prof. Muharrem Zabeli, prodekan, 16 janar 2020.
- 27 CV-të e stafit të Fakultetit të Gjeoshkencave, Faqja e UMIB, Nga vegëza: <https://www.umib.net/fakulteti-i-gjeoshkencave/stafi-akademik/>.
- 28 Lista e dërguar nga Ahmet Jashari, Drejtor për Informim dhe Komunikim me Publikun, 15 janar 2020.
- 29 CV-të e stafit të Fakultetit të Gjeoshkencave, Faqja e UMIB, Nga vegëza: <https://www.umib.net/fakulteti-i-gjeoshkencave/stafi-akademik/>.
- 30 Listë e dërguar përmes email-it nga prof. Behxhet Shala, e përcjellë nga sekretarja Ermira Sopa, 22 janar 2020.
- 31 Listë e dërguar përmes emailit nga prof. Muharrem Zabeli, prodekan, 31 janar 2020.
- 32 Lista e dërguar nga Ahmet Jashari, Drejtor për Informim dhe Komunikim me Publikun, 15 janar 2020.
- 33 Lista e dërguar nga Ahmet Jashari, Drejtor për Informim dhe Komunikim me Publikun, 13 janar 2020.
- 34 Lista e dërguar nga Ahmet Jashari, Drejtor për Informim dhe Komunikim me Publikun, 13 janar 2020.
- 35 Lista e dërguar nga Ahmet Jashari, Drejtor për Informim dhe Komunikim me Publikun, 15 janar 2020.
- 36 Lista e dërguar nga Ahmet Jashari, Drejtor për Informim dhe Komunikim me Publikun, 15 janar 2020.
- 37 Intervistë përmes email-it me prof. Zafire Bajraktari-Gashi, 11 janar 2020.
- 38 Intervistë me prof. Naser Peci, dekan në Gjeoshkenca, 27 dhjetor 2020, Mitrovicë.
- 39 Intervistë përmes email-it me prof. Nazmi Hasi, 9 janar 2020, Mitrovicë.
- 40 Ibid.
- 41 Intervistë me prof. Sylejman Hyseni, 9 janar 2020, Mitrovicë.
- 42 Intervistë me prof. Afrim Koliqi, 9 janar 2020, Mitrovicë.
- 43 Intervistë me prof. Behxhet Shala, prorektor për bashkëpunim ndërkombëtar, 9 janar 2020, Mitrovicë.
- 44 Intervistë me prof. Sabri Avdullahi, 9 janar 2020, Mitrovicë.
- 45 Ibid 5

- 46 Intervistë me prof. Muharrem Zabeli, prodekan në Gjeoshkenca, 27 dhjetor 2020, Mitrovicë.
- 47 Ibid 3.
- 48 Intervistë përmes email-it me prof. Izet Ibrahimimi, 9 janar 2020.
- 49 Ibid 6.
- 50 Ibid 8.
- 51 Intervistë me prof. Alush Musaj, rektor i UMIB-it, 27 dhjetor 2020, Mitrovicë.
- 52 Ibid 12.
- 53 Ibid 5.
- 54 Ibid 8.
- 55 Intervistë me prof. Kemajl Zeqiri, anëtar i Bordit të KPMM, 13 janar 2020, Prishtinë.
- 56 Ibid 12
- 57 Intervistë përmes email-it me prof. Zenun Elezaj, 12 janar 2020.
- 58 Përgjigje përmes emailit nga Skënder Bucolli, drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun në KEK, 27 janar 2020.
- 59 Përgjigje përmes emailit nga Skënder Bucolli, drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun në KEK, 2 tetor 2019.
- 60 Intervistë me Bajram Mustafën, Drejtor i Departamentit për Hulumtim, Zhvillim dhe Mjedis në Trepça Sh.A, 24 dhjetor 2019, Mitrovicë.
- 61 Intervistë me prof. Kemajl Zeqirin, anëtar i Bordit të KPMM, 13 janar 2020, Prishtinë.
- 62 Intervistë përmes emailit me Bajram Mustafën, Drejtor i Departamentit për Hulumtim, Zhvillim dhe Mjedis në Trepça Sh.A, 20 janar 2020, Mitrovicë.
- 63 Intervistë me Bajram Mustafën, Drejtor i Departamentit për Hulumtim, Zhvillim dhe Mjedis në Trepça Sh.A, 24 dhjetor 2019, Mitrovicë.
- 64 Intervistë me Ramiz Krasniqin, Drejtor i KPMM, 10 janar 2020, Prishtinë.
- 65 “Industria e Shkatërrimit”, Preportr, Grup autorësh, 12 korrik 2019, Prishtinë. Nga vegëza: <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Industria-e-shkaterrimit-292>
- 66 Intervistë me Ramiz Krasniqin, Drejtor i KPMM, 10 janar 2020, Prishtinë.
- 67 Intervistë me prof. Kemajl Zeqiri, anëtar i Bordit të KPMM, 13 janar 2020, Prishtinë.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

378.1(496.51)(047.53)

Memeti, Aulonë

Gjendja në Fakultetin e Gjeoshkencave të Universitetit
të Mitrovicës (UMIB) / Aulonë Memeti dhe Ardit Kika.
– Prishtinë : ADMOVERE, 2020 . – 31 f. ; ilustr. ; 21 cm.

1.Kika, Ardit

ISBN 978-9951-8961-9-1

